# DËSHMI ARKIVI

**A-450418**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ambasadori gjerman bën thirrje që aktgjykimi të respektohet |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/ambasadori-gjerman-ben-thirrje-qe-aktgjykimi-te-respektohet/1015069/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 19:34:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 19:33:48 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `caea76f221e5a29528d46f1857b8d40af911cbcb2db34df9d313dc4a60b51de1` |
| TEKSTI | `83a0d0d47dcf12a9c77951eee4fa87267a879d8117c71df871814a15c120c3bf` |
| PAMJA | `eaee0a9daf408947b6ff8bc9afc03376650717ccaa58292483f6c7585c397c58` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a037e4af09988bad05cfa30a02e7f81a49af94061fa41793e249fec32c159dd7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a037e4af09988bad05cfa30a02e7f81a49af94061fa41793e249fec32c159dd7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ambasadori gjerman bën thirrje që aktgjykimi të respektohet



Rainer Rudolph, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve.

Sipas ambasadorit, procesi gjyqësor kishte në fokus pretendimet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai nënvizoi se, ashtu siç sqaroi kryetari i trupit gjykues gjatë dhënies së aktgjykimit, në bankën e të akuzuarve nuk ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës si organizatë dhe as qëllimi i saj për pavarësinë e Kosovës.

Rudolph deklaroi se Gjermania e ka përkrahur që prej fillimit veprimtarinë e Dhomave të Specializuara, të cilën e sheh si një ndihmesë të rëndësishme për trajtimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe për afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian. Ai u kërkoi të gjitha palëve ta respektojnë vendimin gjyqësor.

Më poshtë është deklarata e plotë e ambasadorit gjerman në Kosovë për shpalljen, më 16.09.26, të aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë në procesin kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve:

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhanë sot aktgjykimin e tyre. Procesi u përqendrua tek akuzat që lidhen me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Gjatë shpalljes së vendimit, kryetari i trupit gjykues bëri të qartë se gjykimi nuk kishte si objekt Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në tërësi dhe as aspiratën e saj për ta bërë Kosovën të pavarur.

Mbështetja e Gjermanisë për punën e Dhomave të Specializuara ka qenë e vazhdueshme, nisur nga vlerësimi se kjo punë jep një kontribut të rëndësishëm në adresimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, në konsolidimin e sundimit të ligjit dhe në procesin e afrimit të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Kosova, në cilësinë e një shteti sovran dhe të pavarur, ka treguar se po e përmbush përgjegjësinë e saj edhe për trajtimin e krimeve të luftës, si nëpërmjet krijimit të Dhomave të Specializuara, ashtu edhe përmes bashkëpunimit

të fundit/


Mitrovica në heshtje pas aktgjykimit të Hagës


Volvo XC60 i rifreskuar arrin rekord të ri të autonomisë elektrike


Berisha reagon ndaj aktgjykimit në Hagë: Vendim i papreceden…


QMK: Nga 11 zjarre në ambiente të hapura, dy vijojnë të jenë aktive…


Saveski: Mungesa e stafit detyron një prokuror të mbulojë…


Mediumi turk analizon Amedsporin e Besnik Hasit: Skema të…


Meidani kundërshton vendimin e Hagës: Në emër të kujt flet Gjyk…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

me ICTY-në.

Vendimi i shpallur nuk i çliron në asnjë formë aktorët jugosllavë nga përgjegjësia për konfliktin e armatosur dhe për shkeljet masive të të drejtave të njeriut ndaj popullsisë së Kosovës në fund të viteve '90. Këto shkelje janë hetuar më parë nga gjykatat ndërkombëtare dhe kanë sjellë ndërhyrjen e komunitetit ndërkombëtar.

Të gjitha palëve u bëjmë thirrje ta pranojnë dhe ta respektojnë aktgjykimin, si dhe të tregojnë respekt për dinjitetin e viktimave.

Shtuar më 16.09.2026 21:33

Tags: Aktgjykimi , ambasadori , Rainer Rudolph



Mitrovica në heshtje pas aktgjykimit të Hagës



Berisha reagon ndaj aktgjykimit në Hagë: Vendim i paprecedentë,…



Meidani kundërshton vendimin e Hagës: Në emër të kujt flet Gjykata…



Rrahmani nga protesta para Qeverisë: Aktgjykimi i Speciales është i padrejt…



Deputeti i LDK-së: Thaçi do të zgjidhej president sonte me 100 vota



Besnik Tahiri: Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së është politik dhe i padrejtë



Mirror raporton për dënimin e Hashim Thaçit dhe vendimin e gjykatës



Protestuesit kundërshtojnë vendimin e Speciales dhe kërkojnë reagim…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.